



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 442/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkritazi për ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të mosfunksionimit të sprejt dhe të baterive fluoreshente, në seancën e panelit të mbajtur me 23.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosja (LVV).

A r s y e t i m

PZAP, ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik LVV, ne te cilën pretendohet se gjate ditës se zgjedhjeve dt, 12.12.2010 nuk ka funksionuar sprejt dhe bateritë fluoreshente në Qendrat e Votimit (QV) në Mitrovicë: Shkolla filllore “Migjeni” – Ilirida; Shkolla filllore “Abdullah Shabani” – Ilirida; Shkolla filllore “Fazli Grajqevci” – Shipol; Shkolla filllore “Shaban Idrizi” – Zhabar; Shkolla filllore “Skënderbeu” – Vaganicë; Rruga “Sami Frashëri” 57 lagjja e Boshnjakëve; Shkolla Filllore “Aziz Sylejmani” – Kodra e Minatorëve; Shkolla filllore “Anton Zako Çajupi” – Qendër; Shkolla filllore “Bedri Gjinaj” – Sitnicë; Shkolla filllore “Hivzi Sylejmani” – Kqiq; Shkolla filllore “Bajram Curri” – Gushavcë; Shkolla filllore “Bajram Curri” – Vidimiriq; Shkolla filllore “Minatorët” – Rahovë; Shkolla filllore “Trepça” Mazhiq; Shkolla filllore “Mehë Uka” – Bajgorë; Shkolla filllore “Jusuf Rexha” – Koshtovë; Shkolla “Bujqësore” – Lagja e Romëve; Shkolla filllore “Bislim Hajdari” – Kaqandoll; Shkolla filllore “Habib Jusufi” – Vllahi; Shkolla filllore “Rifat Vidishiqi” – Bare; Shkolla filllore “Elena Gjika” – Tuneli i parë; Shkolla filllore “1 Maji” – Shupkofcë; Shkolla filllore “Sefedin Smakaj” – Rshanë; Shkolla filllore “Fazli Grajqevci” – Vërbnicë dhe shkolla filllore “Trepça” – Melenicë. Parashtruesi i ankesës konsideron se është shkelur neni 7 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore nr. 09/2009, prandaj kërkon nga PZAP-i që te marri masa ndëshkuese.

PZAP-i, në kuptim 118.4 të LZP-së, i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe duke vepruar sipas udhëzimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë, të theksuara në Aktgjykimin A.A.131/2010 të datës 17.12.2010, e pas vlerësimit të gjithë anshëm të shkresave të lëndës, gjeti se:

- ankesa është e pabazuar.

Neni 59 paragrafi 2 dhe paragrafi 3 pika (d) të LZP-së, parashohin:

59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve në pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji. Nga kjo dispozite ligjore rezulton se KQZ në kuadër të përgatitjes së zgjedhjeve bën edhe sigurimin e llapave fluoreshente efikase për shënimin e votuesit se një here ka votuar.

Përgjegjësitë dhe Funksonet e KQZ-së

Neni 64 paragrafi 1 dhe neni 64 paragrafi 2 pika (a) të LZP-së parashohin:

64.1 KQZ-ja është përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji.

64.2 a) KQZ-ja përgatit dhe shpall rregullat për zgjedhjet, ndërsa në nenin 122.1 të LZP është parapare mundësia e apelimit të personave fizik dhe juridik të drejtat e të cilëve janë prekur me vendimet e KQZ të precizuara me afër në pikën a), b) c), d), e) dhe f) të kësaj dispozite juridike.

Me që në dispozitën juridike të lartcekur nuk është parapare mundësia e apelimit kundër KQZ për llapat fluoreshente, dhe për këtë shkak mundësia e apelimit kundër KQZ nuk është parapare as në ndonjë dispozite tjetër të LZP, PZAP,-i konkludon se paraqitja e ankesës kundër KQZ për mosfunksionim të këtyre llapave bien nën administrimin e KQZ-së. Ndërkaq vet KQZ i është lënë mundësia ligjore në kuptim të nenit 106.2 të LZP që të përsëris votimin në një qendër votimi apo në një komune, nëse gjen se është dëmtuar rendë procesi zgjedhor në at qendër votimi apo në at komune. Me nenin 120 të LZP ku është parapare e drejta e PZAP-it që vetëm në raste të jashtëzakonshme të shqiptoj sanksione, anuloj rezultate të votimit etj, ndërkaq në këtë dispozitë nuk është parapare që PZAP-i mundet edhe ndaj KQZ të shqiptoj ndonjë sanksion, por vetëm mundet të urdhëroj KQZ të përsëris votimin në një qendër votimi apo vendvotim nëse konsideron se ka ndikim në rezultatet finale, çka nuk është kjo situatë në rastin konkret.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 6 paragrafi 4 parasheh:

Panelet vendim-marrëse mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo ato të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast prima facie .

PZAP –i për arsyet e lartpërmendura gjen se ankesa e paraqitur është e pabazuar, andaj edhe vendosi si në dispozitiv në kuptim të nenit 118.1 dhe pike 2 të LZP, si dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe procedurave të PZAP-it të dt.17 nëntor 2010.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 442/2010 më datën 23.12.2010.

**Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala**

